# GJEOGRAFIA

## GJEOGRAFI FIZIKE

Pyetja 1.
Në cfarë përqindje masat kontinentale të ngritura janë antipode me depresionet tokësore të zëna nga uji oqeanik:
A) 75%
B) 85%
C) 95%
D) 65%

Pyetja 2.
Sa është raporti i sipërfaqes së oqeaneve me atë të kontinenteve:
A) 2.43 me 1
B) 2.33 me 1
C) 2.53 me 1
D) 2.63 me 1

Pyetje 3.
Në cilën gjerësi gjeografike karakteri kontinental(kontinentaliteti) i hemisferës veriore shpjegohet me supozimin e dominimit të lëvizjeve ngritëse:
A) gjerësitë gjeografike 70 gradë.
B)gjerësitë gjeografike 60 gradë.
C)gjerësitë gjeografike 50 gradë.
D)gjerësitë gjeografike 80 gradë.
.
Pyetja 4.
Në cilat gjerësi gjeografike karakteri oqeanik(oqeaniteti) i hemisferës jugore shpjegohet me supozimin e dominimit të lëvizjeve ulëse:
A)gjerësitë gjeografike 70 gradë.
B)gjerësitë gjeografike 60 gradë.
C)gjerësitë gjeografike 50 gradë.
D)gjerësitë gjeografike 80 gradë.

Pyetja 5.
Të gjithë kontinentet kanë formën e trekëndëshit të këthyer nga:
A)Jugu
B)Veriu
C)Perëndimi
DLindja

Pyetja 6.
Sa përqind të sipërfaqes së kontinenteve zenë lartësitë deri 1000 m mbi nivelin e detit?
A)50%
B)60%
C)70%
D)80%

Pyetja 7.
Cili kat batimetrik ze sipërfaqen më të madhe të tabanit të oqeaneve dhe deteve?
A)1000-3000 m
B)2000-5000 m
C)3000- 6000 m
D)4000-7000 m

Pyetja 8.
Cili është drejtimi dominues i vargjeve malorë të kontinenteve dhe në fundin oqeanik?
A) Meridional
B) Veriperëndim-Juglindje
C) Perëndim –Lindje
D)I Crregullt

Pyetja 9.
Cila zonë e" paraleleve kritik" dallohet për ulje të përgjithshme të territorit si në kontinente ashtu dhe në oqeane?
A) $35^0$
B) $61\text{-}62^0$
C) $71^0$
D) $0\text{-}10^0$

Pyetja 10.
Sa është thellësia mesatare dhe volumi i ujit i oqeanit botëror?
A) 4500 m dhe 2 miliard $km^3$
B) 3500 m dhe 1.37 miliard $km^3$
C) 5500 m dhe 1.71 miliard $km^3$
D)2500 m dhe 1.61 miliard $km^3$

Pyetja 11.
Cili është oqeani më i thellë i rruzullit tokësor?
A) Oqeani Paqësor
B) Oqeani Atlantik
C) Oqeani Indian
D) Oqeani i Ngrirë i Veriut

Pyetja 12.
Cilët nga llojet e deteve kanë më shumë komunikim me oqeanin?
A) Detet ndërishullorë
B)Detet e hapur
C) Detet gjysëm të hapur
D) Detet mesdhetarë

Pyetja 13.
Në kuadër të pjesëve të relievit nënujor të kontinenteve, quhet "Shelf":
A) Rrafshnalta anësore
B) Platforma kontinentale
C)Shpati kontinental
D) Kanionet nënujorë

Pyetja 14.
Bazuar në mendimin e Shepard dhe të tjerëve,origjina e kanioneve të mëdhenj që gjenden në tabanin oqeanik e detar është :
A) Vazhdim i luginave të lumenjve të mëdhenj.
B) Origjinë komplekse, rezultat i një historie të gjatë zhvillimi.
C) Nga erozioni në kushte kontinentale.
D) Nga thyerje të thella tektonike.

Pyetja 15.
Çjanë "meridianet kritikë" të rruzullit tokësor që gjenden në kontinente e oqeane?
A) Ngritje të mëdha malore në formën e malësive
B) Depresione të thella e të gjera mjaftë të përzgjatur
C) Vargje të mëdhenj malor meridional e submeridionalë
D) Gropa të të thella e me shtrirje mjaftë të gjerë

Pyetja 16.
Çfarë pozicioni gjeografik kanë përgjithësisht fushat e mëdha kontinentale?
A) Në pjesën e brendshme të kontinenteve
B) Në pjesën veriore të kontinenteve
C) Në pjesën jugore të kontinenteve
C)Në pjesën perëndimore dhe lindore të kontinenteve

Pyetja 17.
Sa është sipërfaqja gjithësej e ishujve të rruzullit tokësorë?
A) 5 milion $km^2$
B) 10 milion $km^2$
C) 12 milion $km^2$
D)15milion $km^2$

Pyetja 18.
Ishujt koralorë janë formuar nga:
A) Depozitimet e ngurta të lumenjve të mëdhenj.

B) Depozitimet e materialeve të vullkaneve nënujorë.
C) Depozitimi i kolonive të organizmave të ndryshëm detarë.
D) Depozitimi i kripave për shkak të avullimit të madh.

Pyetja 19.
Sa është temperatura e përshtatshme për formimin e koraleve?
A) 15 deri $17^0$
B) 10 deri $15^0$
C) 30 deri 35 $^0$
D) 18 deri $30^0$

Pyetja 20.
Deri në cilën thellësi ujore mund të zhvillohen zakonisht koralet ?
A) Deri në thellësinë 25-30 m
B) Deri në thellësinë 150 m
C) Deri në thellësinë 70-100 m
D) Deri në thellësinë 55- 65 m

Pyetja 21.
Sa është trashësia e kores së tokës në kontinente?
A) 10 deri 20 km
B) 15 deri 25 km
C) 20 deri 80 km
D) 5 deri 15 km

Pyetja 22.
Sa është trashësia e kores së tokës në oqeane?
A) 2 deri 5 km
B) 10 deri 12 km
C) 3 deri 6 km
D) 5 deri 10 km

Pyetja 23.
Trashësia mesatare e kores së tokës është:
A) 16-40 km
B) 12 - 30 km
C) 17 - 25 km
D) 18 -35 km

Pyetja 24.
Kora e tokës përbëhet nga shtresa me përbërje të ndryshme shkëmbore.
Sima , si pjesë e saj, përbëhet nga:
A)Shkëmbinjë sedimentarë karbonatikë
B) Shkëmbinjë sedimentarë terrigjenë
C) Shkëmbinjë bazaltikë
D) Shkëmbinjë granitikë

Pyetja 25. Shkëmbinjtë sedimentarë të kores së tokës zenë:
A) 60% të sipërfaqes së kontinenteve
B) 80% të sipërfaqes së kontinenteve
C) 70% të sipërfaqes së kontinenteve
D) 90% të sipërfaqes së kontinenteve

Pyetja 26.
Manteli është shtresa e dytë që vijon posht kores së tokës. Sa është trashësia e mantelit?
A) 2790 km
B)2890 km
C)2680 km
D) 2880 km

Pyetja 27.
Në cilën thellësi fillon bërthama e tokës dhe në cilën thellësi përfundon?
A) Fillon në 2600 km dhe përfundon në 5100 km
B) Fillon në 2700 km dhe përfundon në 5800 km
C) Fillon në 2900 km dhe përfundon në 6371 km
D) Fillon në 2870 km dhe përfundon në 6230 km

Pyetja 28.
Saështë gradienti mesatar i temperaturës së tokës në shtrest e kores posht shtresave të ndikuara nga energjia diellore?
A)$35^0$ për 1 km
B)$20^0$ për 1 km
C)$45^0$ për 1 km
D)$15^0$ për 1 km

Pyetja 29.
Temperatura e tokës në kufirin e mantelit me bërthamën është:
A)$1000\text{-}1200^0$
B)$2000\text{-}2200^0$
C)$3000\text{-}3200^0$
D)$4000\text{-}4200^0$

Pyetja 30.
Sa është temperatura e tokës në pjesën qendrore të bërthamës së saj?
A)$3000^0$
B)$4000^0$
C)$5000^0$
D)$6000^0$

Pyetja 31.
Cila nga vlerat e e mëposhtëme shpreh densitetin mesatar të tokës?
A)0,001293gr/$cm^3$
B)1.o27gr/$cm^3$
C)5.52gr/$cm^3$
D)2.7gr/$cm^3$

Pyetja 32.
Sa është densiteti i tokës në qendër të saj?
A)17.2gr/$cm^3$
B)16.2gr/$cm^3$
C)15.2gr/$cm^3$
D)14.2gr/$cm^3$

Pyetja 33.
Vlera e densitetit të tokës prej 11.5gr/$cm^3$ gjendet në thellësinë:
A)2400 m
B)3200 m
C)5000 m
D)5120 m

Pyetja 34.
Në cilën thellësi fillon rritja më e shpejtë e densitetit të tokës?
A)Në thellësinë 1600 m
B)në thellësinë 2400 m
C)Në thellësinë 4000 m
D)Në thellësinë 2900 m

Pyetja 35.
Cila nga formulimet e mëposhtëme ka të bëjë me trysninë e tokës në drejtimin lart-posht?
A)Trysnia hidrostatike
B)Trysnia litostatike
C)Trysnia atmosferike
D)Trysnia e shtresës

Pyetja 36.
Sa ndryshon gradienti i trysnisë litostatike për cdo 100 m thellësi në tokë?
A)23 kg/$cm^2$
B)33 kg/$cm^2$
C)13 kg/$cm^2$
D)17 kg/$cm^2$

Pyetja 37.
Sa është trysnia litostatike në qendër të tokës?
A)3 milion $kg/cm^2$
B)4.5 milion $kg/cm^2$
C)3.5 milion $kg/cm^2$
D)2.5 milion $kg/cm^2$

Pyetja 38.
Për të gjetur vlerën e forcës së gravitetit të cdo pike është e nevojshme të dihet:
A)Lartësia mbi nivelin e detit e pikës
B)Thellësia nën nivelin e detit e pikës
C)Gjerësia gjeografike e pikës
D)Diferenca midis lartësisë dhe thellësisë

Pyetja 39.
Sa është vlera e deklinacionit midis boshtit magnetik të tokës dhe boshtit të tokës?
A)$12^0$
B)$11^0$
C)$13^0$
D)$10^0$

Pyetja 40.
Në sa vjet fusha magnetike e tokës mund të kryej një rrotullim të plotë rreth tokës?
A)1000 vjet
B)1500 vjet
C)2500 vjet
D)2000 vjet

Pyetja 41.
Madhësiae vlerës së forcës së gravitetit shprehet me anën e:
A)Izohietave
B)Izotermave
C)Izodinameve
D)Izobateve

Pyetja 42.
Sa është kohëzgjatja e ndryshimeve të elementeve të magnetizmit që quhen “stuhi magnetike”?
A)Zgjasin 1 vit
B)Zgjasin nga 1 deri në disa ditë
C)Zgjasin për disa vjet
D)Janë të përhershme

Pyetja 43.
Në nivelin e detit dhe në kushte normale atmosferike shpejtësia e përhapjes së valëve zanore është:
A)335 m/sek
B)435 m/sek
C)235 m/sek
D)125 m/sek

Pyetja 44.
Në cilin grup litologjik bëjnë pjesë shkëmbinjtë gabrorë(gabrot)?
A)Në grupin e karbonatikëve
B)Në grupin e magmatikëve intruziv
C)Në grupin e magmatikëve efuziv
D)Në grupin e terrigjenëve

Pyetja 45.
Në cilën mënyrë përshkueshmëria e zvogëlon veprimtarinë gërryese mbi shkëmbinjtë?
A)Nëpërmjet veprimtarisë tretëse sipërfaqësore
B)Nëpërmjet karakterit masiv të masës shkëmbore
C)Nëpërmjet zvogëlimit të rrjedhjes sipërfaqësore
D)Nëpërmjet karakterit të diferencuar të sipërfaqes

Pyetja 46.
Nëse strukturat monoklinale me shtresa të alternuara të forta-të buta kanë pjerrësi deri 40-$50^0$, çfarë tip forme relievi formohet?
A)Kuest
B)Hogbek
C)Pengesë
D)Kreshtë monoklinale

Pyetja 47.
Nëse strukturat monoklinale me shtresa të alternuara të forta-të buta kanë pjerrësi deri $70^0$, çfarë forme relievi formohet?
A)Hogbek
B)Kuest
C)Pengesë
D)Kreshtë monoklinale

Pyetja 48.
Cilët lloje shkëmbinjësh janë më të qëndrueshëm ndaj tjetërsimit fizik?
A)Shkëmbinjtë magmatikë intruziv
B)Shkëmbinjtë magmatikë efuziv
C)Shkëmbinjtë karbonatikë
D)Shkëmbinjtë terrigjenë

Pyetja 49.
Cilët nga llojet e shkëmbinjve të mëposhtëm tjetërsohen më shumë deri në formimin e argjilave?
A)Granitet
B)Dioritet kuarcore
C)Gabrot
D)Peridotitet

Pyetja 50.
Cilët nga shkëmbinjtë e mëposhtëm janë më shumë rezistent në të gjitha llojet e klimave?
A)Dolomitet
B)Sienitet
C)Gëlqerorët
D)Argjilorët

Pyetja 51.
Kompleksi i formave të relievit strukturor kushtëzohet në radhë të parë nga:
A)Llojshmëria litologjike
B)Tipi i deformimeve tektonike
C)Tipi i klimës
D)Erozioni diferencial

Pyetja 52.
Çfarë tip strukture tektonike krijon stili tektonik në tërheqje?
A)Mbihipje
B)Rrudha
C)Monoklinal
D)Horst-graben

Pyetja 53.
Çfarë tip strukture tektonike krijon stili tektonik në shtypje?
A)Rrudha dhe mbihipje
B)Horst
C)Graben
D)Strukturë horizontale

Pyetja 54.
Në cilin nga llojet e shkëmbinjve të mëposhtëm erozioni diferencial është më i theksuar?
A)Në shkëmbinjtë magmatikë efuziv
B)Në shkëmbinjtë magmatikë intruziv
C)Në shkëmbinjtë me shtresa të alternuara
D)Në kompleksin e shkëmbinjve karbonatikë

Pyetja 55.
Përputhja e relievit me strukturën rrudhosësë antiklinale shprehet në:
A)Formimin e luginave lumore
B)Formimin e kuesteve
C)Formimin e vargjeve malorë
D)Formimin e fushëgropave

Pyetja 56.
Përputhja e relievit me strukturën rrudhosëse sinklinale shprehet në:
A)Formimin e vargjeve kodrinorë
B)Formimin e masiveve malorë
C)Formimin e shkallëve strukturore
D)Formimin e luginave lumore

Pyetja 57.
Në cilin rast relievi në strukturën horstgrabenore është reliev përputhës?
A)Kur në horste formohen male
B)Kur në grabene formohen vargje malorë
C)Kur në horste formohen gropa
D)Kur në grabene formohen malësi

Pyetja 58.
Çfarë kuptojmë me termin tektoorogjenezë?
A)Procesin e formimit të një tip strukture
B)Procesin e formimit të një tip relievi
C)Procesin e formimit të strukturës dhe të relievit
D)Procesin e depozitimit të materialeve të ndryshme

Pyetja 59.
Gjatë cilës erë apo periudhë gjeologjike ka ndodhur tektoorogjeneza kaledoniane?
A)Gjatë periudhës së Paleozoit të poshtëm
B)Gjatë erës së Mesozoit
C)Gjatë erës së Kenozoit
D)Gjatë periudhës së Kuaternarit

Pyetja 60.
Gjatë cilës erë apo periudhë gjeologjike ka ndodhur tektoorogjeneza herciniane?
A)Gjatë erës së Mesozoit
B)Gjatë periudhës së Pleozoit të sipërm
C)Gfjatë erës së Kenozoit
D)Gjatë periudhës së Neogjenit

Pyetja 61.
Gjatë cilës erë apo periudhë gjeologjike ka ndodhur tektoorogjeneza alpine e re(neotektonika)?
A)Gjatë erës së Mesozoit
B)Gjatë periudhës Permiane
C)Gjatë periudhës së Paleogjenit
D)Gjatë periudhës së Neogjenit

Pyetja 62.
Cilët nga malet e mëposhtëm janë malet më të vjetër të rruzullit tokësorë?
A)Malet e Skandinavisë
B)Malet Urale
C)Malet Himalaje
D)Malet kordiliere

Pyetja 63.
Vargjet malore me shtrirje apo formë rrezore janë të lidhura me strukturat:
A)Antiklinale
B)Sinklinale
C)Bllokore
D)Mbihipëse

Pyetja 64.
Ç'është piemonti si formë relievi?
A)Fushëgropë grabenore
B)Rrafsh në lartësi malore
C)Fushë aluvionale në rrëzë të maleve
D)Fushë në një luginë lumore

Pyetja 65.
Cila është faza e tretë e evolucionit të piemontit
A)Formimi i glacis aluvional
B)Coptimi i mbulesës së vjetër aluvionale
C)Deformimi i sipërfaqes topografike nga kodrat e luginat
D)Zhdukja e mbulesës së vjetër aluvionale.

Pyetja 66.
Cila nga fushat e mëposhtëme të vendit tonë ka tiparet e piemontit?
A)Fushëgropa e Korçës
B)Ultësira pranëadriatike
C)Fusha e Delvinës
D)Fusha në Luginën e Vjosës së Sipërme

Pyetja 67.
Strukturë  aklinale do të thotë së është:
A)Strukturë me palosje nga poshtë(sinklinal)
B)Strukturë me palosje nga lartë(antiklinal)
C)Strukturë me rënie nga një krahë
D)Strukturë e sheshtë e padeformuar

Pyetja 68.
Pse në krahun perëndimor strukturat tektonike të Shqipërisë kanë karakter monoklinal?
A)Për shkak të lëvizjeve tektonike me karakter rrudhosës
B)Për shkak të lëvizjeve tektonike horst-grabën
C)Për shkak të lëvizjeve tektonike me karakter mbihipje
D)Për shkak të lëvizjeve që kanë formuar horstantiklinale

Pyetja 69.
Në cilën tip strukture tektonike formohen kuestet?
A)Rrudhosëse
B)Horst-graben
C) Të sheshtë
D)Monoklinale

Pyetja 70.
Nëse midis shtresave shkëmbore të strukturës monoklinale ka ndryshime të theksuara të trashësisë cfarë lloj forme relievi formohet?
A)Shkallë strukturore
B)Taracë denudative
C)Shkallë tektonike
D)Taracë akumulative

Pyetja 71.
Në cilin nga kushtet e mëposhtëme formohet luginë e tipit konsekuent?
A)Kur lugina e lumit zhvillohet në drejtim të kundërt të rënies së shtresave
B)Kur lugina e lumit zhvillohet në drejtim të njejtë me rënien e shtresave
C)Kur lugina e lumit zhvillohet në drejtimin normal me rënien e shtresave
D)Kur lugina e lumit zhvillohet duke prerë një strukturë antiklinale

Pyetja 72.
)Në cilat kushte fillon evolucioni i luginave dhe i gropave antiklinale që përfaqësojnë reliev mospërputhës?
A)Kur një lum can tërthor një strukturë antiklinale
B)Kur gërryhet plotësisht shtresa e fortë dhe del shtresa e butë
C)Kur një lum can tërthor një strukturë sinklinale
D)Kur një luginë formohet në drejtim të njëjtë me shtresën

Pyetja 73.
Në cilin nga rastet e mëposhtme kemi  mospërputhje e relievit me strukturën:
A)Kur lugina është zhvilluar në sinklinal
B)Kur lugina është zhvilluar në graben
C)Kur lugina është zhvilluar në antiklinal
D) Kur lugina është zhvilluar në monoklinal

Pyetja 74.
Çfarë tip relievi formojnë mbylljet periklinale?
A)Relie malor
B)Reliev luginor
C)Reliev gropor
D)Reliev kodrinor

Pyetja 75.
Çfarë tip relievi nga pikpamja gjenetike janë bedlendet(tokat e këqija)?
A)Reliev lumor
B)Reliev strukturor
C)Reliev karstik
D)Reliev denudues

Pyetja 76.
Çfarë lloje veprimtarije kuptojmë me procese denuduese?
A)Veprimtarinë gërryese të lumenjve dhe përrenjve
B)Veprimtarinë tretëse të ujërave rrjedhës
C)Lëvizja e materialeve nëpër shpate për shkak të peshës
D)Lëvizjen e materialeve nëpër shpate nga rrjedhjet ujore

Pyetja 77.
Si bëhet zhvendosja e materialeve gjatë dukurisë së shëmbjes?
A) Në formë të menjëhershme nga lart – poshtë
B)Në formë rryma baltrash dhe selesh
C) Në formë zvarritjeje përgjatë shpatit
D)Në formë kërcimesh në pjesë të ndryshme të shpatit

Pyetja 78.
Sa kohë zgjat zakonisht zhvillimi i kushteve për ndodhjen e shembjeve?
A)Disa vjet
B)Dhjetra vjet
C)Qindra vjet
D)Mijëra vjet

Pyetja 79.
Çjanë rrëshqitjet si dukuri shpatore e gravitative?
A)Zhvendosje e materialeve copëzore të vecuar
B)Zhvendosje e blloqeve të mëdhenj në rrugë ajrore
C)Zhvendosje e shtresave shkëmbore sipas një plani
D)Zhvendosje e materialeve inerte nga ujërat

Pyetja 80.
Sa është pjerrësija e shpatit për ndodhjen e zakonshme të rrëshqitjeve?
A)$20\text{-}35^0$
B)$10 - 15^0$
C)$30 - 45^0$
D)Mbi $45^0$

Pyetja 81.
Në cilët llojë shkëmbinjësh janë më të përhapura rrëshqitjet?
A)Në shkëmbinjtë gëlqerorë
B)Në shkëmbinjtë ranorë
C)Në shkëmbinjtë magmatikë
D)Në shkëmbinjtë argjilorë

Pyetja 82.
Në cilat kushte ndodh solifluksioni në formë thjerzash?
A)Në koren e alterimit të përbërë nga copra të mëdha
B)Në formimet argjilore në kufijtë e plasticitetit
C)Në shpatet e mbuluara nga konet koluvialë
D)Në shpatet e përbëra nga materiale kompakte

Pyetja 83.
Në cilën tip klime ndodhin më shumë rrymat e baltrave?
A)Në klimën e nxehtë
B)në klimën mesatare
C)Në klimën arktike
D)në klimën subarktike

Pyetja 84.
Cila është shtresa e parë e atmosferës?
A)Stratosfera
B)Troposfera
C)Mezosfera
D)Termosfera

Pyetja 85.
Sa është lartësia e troposferës në stinën e verës në ekuator?
A)15 km
B)16 km
C)17 km
D)18 km

Pyetja 86.
Sa është lartësia mesatare e stratosferës?
A)12 – 80 km
B)14 – 84 km
C)15 – 90 km
D)16 – 96 km

Pyetja 87.
Në cilën lartësi të stratosferës temperatura e ajrit fillon e ngrihet?
A)Në lartësinë 13-14 km
B)Në lartësinë 15-16 km
C)Në lartësinë 17-18 km
D)Në lartësinë 19-20 km

Pyetja 88.
Nën ndikimin e cilit faktor sipërfaqja e tokës merr ose përfiton më shumë nxehtësi?
A)Nënndikimin e largësisë tokë-diell
B)Nën ndikimi e lartësisë mbi nivelin e detit
C)Nën ndikimin e pjerrësisë së rrezeve diellore mbi sipërfaqen e tokës
D)Nën ndikimin e shpërndarjes tokë-detë

Pyetja 89.
Sa herë më e madhe është nxehtësia specifike e ujit në krahasim me atë të tokës?
A)2 herë
B)3 herë
C)4 herë
D)5 herë

Pyetja 90.
Sa përqind e masës kontinentale të tokës ndodhet në hemisferën jugor?
A)14%
B)16%
C)19%
D)21%

Pyetja 91.
Deri në sa metra thellësi ngrohet toka nga rrezet e diellit?
A)30 m
B)25 m
C)20 m
D)15 m

Pyetja 92.
Pse në lartësitë 3000 m sasia e energjisë së ardhur është e njejtë me atë në nivel të detit në ekuator?
A)Sepse lagështia absolute zvogëlohet dhe lagështia relative rritet
B)Sepse energjia që vjen në sipërfaqe mbahet nga toka
C)Sepse një pjesë e energjisë që vjen në tokë thithet nga toka e objektet
D)Sepse deri në 3000 m rrezet përshkojnë distancë më të vogël dhe ka transparencë

Pyetja 93.
Sa është konstantja diellore që vjen në kufijtë e jashtëm të atmosferës?
A)1.983 kal/cm$^2$ min.
B)2.983 kal/cm$^2$ min.
C)3.983 kal/cm$^2$ min.
D)4.983 kal/cm$^2$ min.

Pyetja 94.
Sa është bilanci i midis energjisë së ardhur nga dielli dhe asaj të rrezatuar nga toka për në atmosferë?
A)Bilanci 3
C)Bilanci 2
C)Bilanci 1
D)Bilanci 0

Pyetja 95.
Albedoja është raporti midis energjisë së ardhur në tokë dhe asaj të reflektuar në hapësirë. Sa përqind është albedoja në sipërfaqen me borë të freskët?
A)61 – 65 %
B)71 – 75 %
C) 81 – 85 %
D)91 – 95 %

Pyetja 96.
Cili është faktori kryesor që realizon ruajtjen e një temperature të caktuar mbi sipërfaqen e tokës?
A)Karakteristikat e sipërfaqes së tokës
B)Masa e rrezatimi diellor
C)Gjendja fizike e atmosferës
D)Karakteristikat e relievit të tokës

Pyetja 97.
Sa vlerësohet pesha e masës së ajrit në nivelin e detit?
A)4.2 $kg/m^3$
B)3.2 $kg/m^3$
C)2.2 $kg/m^3$
D)1.2 $kg/m^3$

Pyetja 98.
Sa herë më pak se uji peshon 1 litër ajër në $0^0$C në nivel të detit?
A)573 herë më pak
B)673 herë më pak
C)773 herë më pak
D)873 herë më pak

Pyetja 99.
Sa hektopaskal(hPa) vlerësohet gradienti i ndryshimit të presionit me lartësinë?
A)1 hPa për cdo 8.3 m
B)1.5 hPa për cdo 8.3 m
C)2 hPa për cdo 8.3 m
D)2.3 hPa për cdo 8.3 m

Pyetja 100.
Çkuptojmë me termin "tokë"në një kuptim të përgjithshëm?
A)Gjithë shtresa e sipërme e hollë e gjithë kontinenteve
B)Shtresa e hollë e vendosur mbi materialet solide që zhvillon jetën
C)Sipërfaqja e tokës që përdoret për ekonominë bujqësore
D)Sipërfaqja e tokës që përdoret për kultivimin e bimëve të arave

Pyetja 101.
Sa është sipërfaqja e tokës bujqësore në Shqipëri?
A)702700 ha
B)698780 ha
C)588680 ha
D)498780 ha

Pyetja 102.
Cili është përdorimi më i rëndësishëm i tokave?
A)Për pylltari dhe kullota
B)Për urbanizim
C)Për infrastrukturë rrugore
D)Për bujqësi dhe kullota

Pyetja 103.
Cila nga katër komponentët kryesorë përbërës të tokës zë përqindjen më të madhe në përbërjen e saj?
A)Komponenti ujë
B)Komponenti ajër
C)Komponenti lëndë minerale
D)Komponenti lëndë organike

Pyetja 104.
Ç'është biodiversiteti?
A)Tërësia e llojeve të kafshëve që ekzistojnë në cdo mjedis
B)Tërësia e llojeve të bimëve që ekzistojnë në cdo mjedis
C)Tërësia e llojeve të qënieve të gjalla që ekzistojnë në cdo mjedis
D)Tërësia e individëve të cdo specie që ekziston në rruzullin tokësorë

Pyetja 105.
Sa është numri i specieve botës që janë njohur dhe determinuar nga shkenca?
A)12.5 milion
B)1.8 milion
C)2.8 milion
D)15 milion

Pyetja 106.
Cili është kuptimi biogjeografik i termit "boreale"
A)Zonë e ftohtë me bimësi që formon pyje koniferë
B)Zonë e gjerësive mesatare me drurë gjethegjerë
C)Zonë e gjerësive mesdhetare me bimësi shkurresh
D)Zonë me dominim të bimësisë barishtore

Pyetja 107.
Sa është numri i specieve të bimëve me lule të botës?
A)Rreth 100 000 specie
B)Rreth 300000 specie
C)Rreth 1000000 specie
D)Rreth 3000000 specie

Pyetja 108.
Cili është shkaku kryesor që shkakton dëmtim më të madh të biodiversitetit?
A)Sëmundje që prekin specie të ndryshme
B)Gjuetija e pa kontrolluar nga njeriu
C)Ndryshimi dhe zhdukja e habitateve nga ana e njeriut
D)Katastrofat e ndryshme natyore

Pyetja 109.
Sa është numri i specieve të humbura në një vit vetëm në hapësirën e pyjeve tropikale?
A)1000 specie
B)2000 specie
C)4000 specie
D)6000 specie

Pyetja 110.
Gradienti i biodiversitetit si dukuri biogjeografike do të thotë:
A)Shtimi i numrit të llojeve të organizmave nga polet drejt ekuatorit
B)Shtimi i numrit llojeve të organizmave nga ekuatori drejt poleve
C)Zvogëlimi i numrit të llojeve të organizmave nga polet drejt ekuatorit
D)Shtimi i llojeve të organizmave nga lartësi të vogla në lartësi të mëdha

Pyetja 111.
Në cilat zona gjeografike vegjetacioni është organizuar në mënyrë të shtresëzuar në drejtimin vertikal(bimësi me kate brenda një pylli)?
A)Në zonat e gjerësive ekuatoriale e tropikale
B)Në zonat e gjerësive mesatare
C)Në zonat e gjerësive të ftohta subpolare
D)Në zonat e gjerësive polare

Pyetja 112.
Kush nga studiusit e mëposhtëm e konstatoi dhe e përcaktoi dukurinë "hotspotet e biodiversitetit"?
A)David Currie
B)Viviane Paquin
C)Norman Myers
D)Nigel Stork

Pyetja 113.
Nëse i bashkojmë të gjitha zonat e vecanta të tokës të quajtura hotspote të biodiversitetit, sa % të sipërfaqes së tokës zenë?
A)4,32% të të sipërfaqes së tookës
B)3.32% të sipërfaqes së tokës
C)2.32% të sipërfaqes së tokës
D)1.32% të sipërfaqes së tokës

Pyetja 114.
Të gjitha zonat e tokës që janë vlerësuar si hotspote të biodiversitetit mbajnë një fond të caktuar të biodiversitetit. Sa përqind është ky fond?
A)40%
B)50%
C)60%
D)70%

Pyetja 115.
Cili nga përcaktimet e mëposhtme i takon grupit taksonomik "specie"?
A)Grup organizmash me ndryshime në pamjen fizike të individëve që i përbëjnë
B)Grup organizmash me ndryshime gjenetike midis individëve që i përbëjnë
C)Grup organizmash me individë të ngjajshëm dhe që kryqëzohen brenda grupit
D)Grup organizmash me një numër të caktuar individësh që jetojnë në një habitat

Pyetja 116.
Çfarë tregojnë termat biogjeografik "specie", "gjini", "familje"?
A)Grupe organizmash individët e të cilëve nuk kanë asnjë ngjajshmëri
B)Grupe organizmash me individë shumë të ngjajshëm
C)Grupe organizmash që zgjedhin të njejtin habitat për të jetuar
D)Grupe organizmash që përfaqësojnë një njësi të caktuar taksonomike

Pyetja 117.
Çfarë kuptojmë me termin "areal"?
A)Një hapësirë gjeografike ku jeton një organizëm
B)Një hapësirë gjeografike ku jeton një njësi taksonomike
C)Një territor që përdoret nga organizmat vetëm për riprodhim
D)Një territor i papërshtatshëm për jetën e organizmave

Pyetja 118.
Cilat janë kushtet karakteristike mjedisore në të cilat zhvillohen bimët mezofite?
A)Kushte ndricimi të plotë dhe tokë e thatë
B)Lagështi e madhe kombinuar me periudha thatësie
C)Kushte me lagështi mesatare dhe hije gjatë vitit
D) Kushte mjedisore pak të lagështa dhe me hije

Pyetja 119.
Çfarë quhet bashkëjetesa e disa lloje organizmash në një shoqërim?
A)Biocenozë
B)Biomë
C)Ekosistem
D)Biosferë

Pyetja 120.
Cili është niveli i parë ushqyes i zinxhirit ushqimor?
A)Herbivorët
B)Karnivorët
C)Detritorët
D)Producentët

Pyetja 121.
Sa përqind e energjisë së trupit të tyre përdorin kafshët?
A)0.1 deri 14%
B)0.1 deri 13%
C)0.1 deri 10%
D)0.1 deri 12%

Pyetja 122.
Çështë ekotoni  si tip habitati?
A)Habitat i përcaktuar tokësorë
B)Habitat i përcaktuar ujorë
C)Habitat tranzitorë (ndërkufitar)
D)Habitat me origjinë humane

Pyetja 123.
Çështë tipi i rrugës të lëvizjes së organizmave e quajtur "koridori filtër"?
A)Koridor me varietet të madh habitatesh
B)Koridor me varietet të kufizuar habitatesh
C)Rrugë ku organizmat lëvizin aksidentalisht
D)Rrugë ku organizmat lëvizin me ndihmën e njeriut

Pyetja 124.
Si spjegohet ekzistenca e  relikteve të evolucionit?
A)Me ndryshimin e  dukshëm të kushteve klimatike
B)Me ndryshimin e kushteve fiziko-kimike të territorit
C)Me paaftësinë fiziologjike të organizmave për përshtatje
D)Me ndodhjen e dukurive natyrore katastrofike

Pyetja 125.
Ku konsiston "Ligji i minimumit" i fiziologut gjerman  Liebig?
A)Elementet ushqyes mungues të organizmit mund të zevendësohen
B)Një faktor kufizues për një organizëm të caktuar është vdekjeprurës për të
C)Nuk kanë rëndësi elementet përbërës të biotopit se organizmat përshtaten
D) Nëse mungon një element ushqyes i domosdoshëm zhvillimi normal ndërpritet

Pyetja 126.
Ku konsiston pasoja më e zakonshme e një konkurence të fortë dhe eficente midis organizmave"
A)Njeri prej organizmave mund të largohet nga ai territor(habitat)
B)Njëri nga organizmat mund të zhduket për shkak të përjashtimit nga territori
C)Organizmi më i dobët mund të mbijetojë në atë territor me mungesa ushqimore
D)Organizmi më i dobët mund të ndryshojë dietë ushqimore për të mbijetuar

Pyetja 127.
Çështë dukurija e komensializmit si faktor biotik?
A)Formë e konkurencës
B)Formë e simbiozës
C)Forme e parazitizmit
D)Formë e grabitshmërisë

Pyetja 128.
Çështë specia kyce në një ekosistem?
A)Një specie dominuese në ekosistem
B)Një specie konkuruese e të gjitha të tjerave
C)Një specie e domosdoshme për jetën e të tjerave
D)Një specie në sinbiozë me speciet e tjera

Pyetja 129.
Ekologjisti britanik Charles Elton në vitin 1950 studioi:
A)Lidhjen midis biodiversitetit dhe funksionimit të ekosistemit
B)Lidhjet midis komuniteteve të bimëve në ekosistem
C)Tolerancat klimatike të organizmave në ekosistem
D)Rolin e organizmave kyc në ekosistem

Pyetja 130.
Në cilën temperaturë drurët gjetherënës të klimës mesatare pësojnë dëmtime fizike e fiziologjike?
A)Në temperaturën $-20^0$
B)Në temperaturën $-30^0$
C)Në temperaturën $-40^0$
D)Në temperaturën $-50^0$

Pyetja 131.
Në cilën temperaturë u bazua Colin Prentice në studimet e tij për të përcaktuar tolerancën termike të formacioneve të ndryshme bimore?
A)Në temperaturën mesatare vjetore
B)Në temperaturën minimale
C)Në temperaturën maksimale
D)Në amplitudën termike mesatare

Pyetja 132.
Cila është ngarja kryesore natyrore që ka ndodhur gjatë periudhës së Holocenit?
A)Një fazë e rëndësishme e akullzimit
B)Lëvizje të fuqishme ngritëse të relievit
C)Fillimi i stabilizimit të klimës që kemi sot
D)Regresione të fuqishme detare

**GJEOGRAFI HUMANE**

Pyetja 1.
Relievi ndikon në përqëndrimin e popullsisë në një zonë me:
A) Formën e tij
B) Klimën
C) Ekonominë
D) Aspektin religjioz

Pyetja 2.
Dallohen per përqendrim më të lartë të popullsisë:
A) Territorret malore
B) Territoret shkembore
C) Territoret fushore
D) Territoret kodrinore

Pyetja 3.
Përcaktoni pohimin e gabuar:
A) Territorret pranëujore nxitin aktivitet ekonomik për popullsinë.
B) Territoret pranëujore shfrytëzohen për transport ujor të popullsisë.
C) Territoret pranëujore dallohen si qendra te rëndësishme të popullimit.
D) Territoret pranëujore dallohen si zona te zhvilluara industriale.

Pyetja 4.
Më shumë se gjysma e popullsisë së botës jeton :
A) Përreth paraleleve 10º dhe 30º
B) Përreth paraleleve 20º dhe 40º
C) Përreth paraleleve 20º dhe 60º
D) Përreth paraleleve 40º dhe 60º

Pyetja 4.
Me termin *anekumena* kuptojmë:
A) Hapsirën në të cilën njeriu nuk është në gjendje të përshtatet për të siguruar jetesën e tij.
B) Hapsirën në të cilën njeriu është i aftë të përshtatet e të bëjë të mundur ekzistencën e vet.
C) Hapsirën tranzitore nga një zonë e banuar nga njerëzit në një tjetër që nuk jep mundësi jetese.
D) Asnjera nga keto

Pyetja 5.
Cili nga kontinentet ka dendësine më të lartë të popullsisë për km²:
A)Europa
B) Afrika
C) Azia
D) Amerika e Veriut

Pyetja 6.
Përcaktoni shtetin me dendësinë më të lartë të popullsisë për km²:
A) Tajvani
B) Bangladeshi
C) Haiti
D) Bahrein

Pyetja 7.
Në klasifikimet e dendësisë, konsiderohen si vende *më dendësi mesatare* ato me:
A) Popullsi nga 100-150 banorë/ km²
B) Popullsi nga 80-100 banorë/ km²
C) Popullsi nga 70-120 banorë/ km²
D) Popullsi nga 50-100 banorë/ km²

Pyetja 8.
Popullsia e botës arriti në 1 miliard banorë:
A) në fillimet e shekullit XVIII
B) në fillimet e shkeullit XIX
C) në fillimet e shekullit XX
D) asnjë nga keto

Pyetja 9.
Shtimi natyror i popullsisë realizohet në numër absolut kur:
A) numri i vdekjeve është më i ulët se numri i lindjeve
B) numri i vdekjeve është më i lartë se numri i lindjeve
C) numri i lindjeve është i barabartë me numrin e vdekjeve
D) asnjë nga keto

Pyetja 10.
Cili nga këto shtete ka lindshmërinë më të lartë:
A) Turqia
B) Afganistani
C) Nigeria
D) Guatemala

Pyetja 11.
Cili nga këto shtete ka vdekshmërinë më të lartë:
A) Ukraina
B) Sierra Leone
C) Nigeria
D) Haiti

Pyetja 12.
Shtimin natyror më të ulët të popullsisë e ka:
A) Gjermania
B) Japonia
C) Kanadaja
D) Uruguaj

Pyetja 13.
Percaktoni emërtimin e gabuar në format e riprodhimit të popullsisë:
A) Riprodhim i thjeshtë
B) Riprodhim i moderuar
C) Riprodhim i zgjeruar
D) Riprodhim i zvogluar

Pyetja 14.
Cili nga emrat e mëposhtëm nuk bën pjesë në teoritë pozitiviste të shtimit të popullsisë:
A) Aristoteli
B) Makiaveli
C) Petti
D) Tempell

Pyetja 15.
Sipas teorisë së Maltusit:
A) Popullsia dhe mundësitë për ushqim dyfishohen me të njejtin progresion.
B) Popullsia dyfishohet në progresion gjeometrik dhe mundësia për ushqim qendron stabël.
C) Popullsia dyfishohet në progresion gjeometrik dhe mundesia për ushqim dyfishohet në progresion aritmetik.
D) Asnjë nga këto

Pyetja 16.
Në strukturën moshore të popullsisë, grupmosha e punës përfshin intervalin:
A) 15 vjeç - 54vjeç
B) 15 vjeç - 59 vjeç
C) 15 vjeç - 64 vjeç
D) 15 vjeç - mosha e ligjshme për pension

Pyetja 17.
Piramida moshore e popullsisë përfaqson:
A) analizën e strukturës gjinore të një popullsie në varësi të faktorëve ekonomike
B) analizën e strukturës gjinore të një popullsie në varësi të faktorëve shëndetsorë
C) paraqitjen grafike të raporteve mes moshës e gjinisë së një popullsie të caktuar
D) asnjë nga këto

Pyetja 18.
Struktura profesionale e popullsisë përfaqson:
A) popullsinë e arsimuar
B) popullsinë aktive
C) popullsinë rurale
D) popullsinë urbane

Pyetja 19.
Në varësi të zhvillimit ekonomik të një vendi, struktura të veçanta ekonomike burojnë nga profesione të ndryshme. Gjeni gabimin në ndarjen e mëposhtme të sektorëve ekonomike:
A) Sektori primar
B) Sektori i ndërmjetëm
C) Sektori sekondar
D) Sektori terciar

Pyetja 20.
Cili nga këto shtete ka peshën më të lartë specifike të popullsisë urbane:
A) Belgjika
B) Bahrein
C) Bahamas
D) Venezuela

Pyetja 21.
Cili nga këto shtete ka peshën më të lartë specifike të popullsisë rurale:
A) Butani
B) Etiopia
C) Haiti
D) Ruanda

Pyetja 22.
Cili nga përcaktimet e mëposhtme tregon *emigrimin*:
A) Procesi i zhvendosjes  së një grupi njerëzish nga një vend ne një tjetër
B) Procesi i zhvendosjes  se nje grupi njerezish jashte kufijve administrative te nje shteti te caktuar
C) Procesi i vendosjes së një grupi njerëzish të ardhur nga një vend i caktuar
D) Asnjë nga keto

Pyetja 23.
Migrimi i përhershëm dhe i përkohshëm përcaktohen:
A) Nga pikpamja e distancës së lëvizjes
B) Në varësi të mënyrës s organizimit
C) Në varësi të kohëzgjatjes
D) Në varësi të mënyrës së migrimit

Pyetja 24.
Tendenca me e dukshme e migrimit te brendshem kudo ne bote konsiston ne:
A) Levizje te popullsise nga zonat fushore drejt atyre malore
B) Levizje te popullsise nga zonat urbane drejt atyre rurale
C) Levizje te popullsise nga zonat rurale drejt atyre urbane
D) Levizje te popullsise zonat nga bregdetare drejt brendesise

Pyetja 25.
Percaktoni detajin e gabuar ne elementet dallues te racave njerezore:
A) Ngjyra e lëkurës
B) Gjuha e folur
C) Paraqitja fizike
D) Ndërtimi anatomik

Pyetja 26.
Cila nga racat e mëposhtme është më pak e përhapur:
A) Mongoloide
B) Evropoide
C) Austroloide
D) Negroide

Pyetja 27.
Vendbanimet më të hershme të njerëzimit përfaqsohen nga :
A) Vendbanime malore
B) Vendbanime urbane
C) Vendbanime rurale
D) Vendbanime stinore

Pyetja 28.
Politikat pronataliste ndikojnë në disa elemente të popullsisë. Cili element bën përjashtim?
A) rritje të shtimit natyror të popullsisë
B) shtim të martesave e lindjeve
C) riprodhim të zgjeruar të popullsisë
D) ndryshim të mortalitetit

Pyetja 29.
Politikat negativiste nataliste nuk i dallojmë në:
A) Evropë
B) Indi
C) Kinë
D) Kore e Jugut

Pyetja 30.
Politikat e planifikimit familjar patën fillimet e tyre në vitet:
A) 1950-1960
B) 1960-1970
C) 1970-1980
D) 1980-1990

Pyetja 31.
Gjeopolitika përfaqson:
A) Disa hipoteza neutrale apo objektive
B) Një reflektim(mendim) që paraprin veprimin politik
C) Interes për shtrirjen hapsinore të dukurive politike
D) Parashikim për zhvillime të mundshme natyrore

Pyetja 32.
Cili nga elementet e mëposhtëm nuk përbën një element kryesor të fuqisë së shtetit?
A) Pozicioni gjeografik dhe sipërfaqja e tij
B) Popullsia e tij
C) Rezervat ekonomike
D) Kufijtë e tij

Pyetja 33.
Përmasa ideale e çdo shteti shihet e varur nga:
A) Raporti mes shtrirjes territoriale dhe numrit të banorëve
B) Raporti mes popullsisë së tij dhe produktit natyror të realizuar
C) Raporti mes sipërfaqes së populluar dhe asaj të papopulluar
D) Raporti mes shtrirjes territoriale dhe mundesisë për zgjerim

Pyetja 34.
Federalizmi modern ka lindur ne:
A) Gjermani
B) SHBA
C) Australi
D) Kanada

Pyetja 35.
Në shtetet federale ku kryeqyteti themelohet mbi një distrikt federal, ky territor:
A) I përket shtetit ku bën pjesë
B) I përket shteteve kufitare
C) Nuk i përket asnjë shteti të veçantë
D) Asnjë nga këto

Pyetja 36.
Australia si shtet federal përbëhet nga:
A) 4 shtete
B) 5 shtete
C) 6 shtete
D) 7 shtete

Pyetja 37.
Ne cilin nga shtetet e mëposhtme, forma e shtrirjes bën të parealizueshme strukturën hekurudhore nga njeri cep në tjetrin:
A) Tajlanda
B) Finlanda
C) Kili
D) Argjentina

Pyetja 38.
Alaska është shembulli i një shteti:
A) Polimerik
B) Bregdetar
C) I ndërprerë
D) Kompakt

Pyetja 39.
"Shtetet kushinete" dallohen për funksionin e tyre:
A) Mbrojtës
B) Amortizues
C) Ndihmës
D) Asnjë nga këto

Pyetja 40.
Islanda shfrytëzon pozicionin e vet strategjik në:
A) Lundrimet transatlantike
B) Fluturimet transatlantike
C) Shkëmbimet transatlantike
D) Asnjë nga këto

Pyetja 41.
Shteti është:
A) një territor i organizuar politikisht dhe që njihet ndërkombëtarisht
B) një organizim social, sovran i njohur ndërkombetarisht
C) një territor i organizuar politikisht, sovran, dhe i njohur ndërkombetarisht
D) asnjë nga këto

Pyetja 42.
Cili nga rastet e meposhtme nuk perfaqson nje shtet dykombesh:
A) Zvicra
B) Kanadaja
C) Belgjika
D) Afrika e Jugut

Pyetja 43.
Në cilin nga shtetet e mëposhtme nuk kanë ekzistuar forcat centrifuge:
A) Çekosllovaki
B) Jugosllavi
C) Bashkimi Sovjetik
D) Gjermani

Pyetja 44.
Forcat centripete tentojnë të:
A) forcojnë kohezionin e shtetit
B) kërcënojnë ekzistencën e shtetit
C) dobësojnë peshën politike të tij
D) asnjë nga këto

Pyetja 45.
Cili nga shtetet e mëposhtme ka në territorin e vet tre ose më shumë grupe etnike
A) Finlanda
B) Algjeria
C) India
D) Zambia

Pyetja 46.
Veprimtaria e dekadave të fundit të shekullit të kaluar në territorin e Qipros konsiderohet si:
A) nacionalizëm
B) irredentizëm
C) patriotizëm
D) asnjë nga këto

Pyetja 47.
Në hartografinë elektorale, termi *xherrimanderiëem* do të thotë:
A) konfigurim i thjeshtë i kufijvë te zonave elektorale sipas dendësisë së popullsisë
B) shtremberim i paramenduar i kufijve të zonave elektorale në funksion të shtimit të përkrahësve
C) përcaktim i kufijve të zonave elektorale sipas ndarjeve ekzistuese administrative
D) asnjë nga këto

Pyetja 48.
Një handikap të konfigurimit të zonave elektorale në Shqiperi përbën:
A) Shtrirja e tyre lindje-perendim
B) Shtrirja e tyre veriperendim-juglindje
C) Shtrirja e tyre veri-jug
D) Shtrirja e tyre perëndim-lindje

Pyetja 49.
Në Shqipëri, brezi i mbizotrimit të votës së hapur është:
A) hapësira gjeografike e Shqiperisë së Veriut
B) hapësira gjeografike e Shqipërise së Jugut
C) hapësira gjeografike e Shqipërisë sëMesme
D) asnjera nga këto

Pyetja 50.
Sistemet zgjedhore me *listë te hapur, me listë të mbyllur apo në bazë rajoni*, bëjnë pjesë në:
A) sistemet zgjedhore proporcionale
B) sistemet zgjedhore mazhoritare
C) sistemet zgjedhore te perziera
D) asnjenga keto

Pyetja 51.
Ne sistemet zgjedhore mazhoritare nuk aplikohen
A) sistemi mazhoritar me një raund
B) sistemi mazhoritar me dy raunde
C) sistemi mazhoritar me tre raunde
D) sistemi mazhoritar me 50%+1 të votave

Pyetja 52
Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB/ONU), u themelua më:
A) 26 qershor 1945
B) 24 tetor 1945
C) 9 prill 1946
D) 10 maj 1946

Pyetja 53.
Sa prej shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së kanë të drejtën e “vetos”:
A) 3 shtete
B) 4 shtete
C) 5 shtete
D) 6 shtete

Pyetja 54.
Mandati i Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së zgjat:
A) 3 vjet
B) 4 vjet
C) 5 vjet
D) 6 vjet

Pyetja 55.
Banka Botërore si një organizëm ndërkombëtar ka si president:
A) Një shtetas amerikan
B) Një shtetas europian
C) Një shtetas izraelit
D) Asnje nga këto

Pyetja 56.
Drejtori i Përgjithshëm i FMN-së është:
A) Një shtetas amerikan
B) Një shtetas europian
C) Një shtetas izraelit
D) Asnjë nga këto

Pyetja 57.
Traktati për themelimin e Organizatës së Atlantikur Verior (NATO) u nënshkrua në vitin:
A) 1948
B) 1949
C) 1951
D) 1952

Pyetja 58.
Organizata Europiane e Tregëtisë së Lirë njihet ndryshe si:
A) TPE
B) OBT
C) EFTA
D) Asnjë nga këto

Pyetja 59.
Traktati që themeloi Bashkimin Europian (BE), u nënshkrua në:
A) Romë
B) Paris
C) Mastriht
D) Amsterdam

Pyetja 60.
Parlamenti Europian mblidhet në:
A) Paris
B) Strasburg
C) Bruksel
D) Amsterdam

Pyetja 61.
Roli kyç i OSBE-se konsiston në:
A) nxitjen e sigurisë e stabilitetit mes vendeve
B) thellimin e marrëdhënieve reciproke
C) bashkëpunimin në fusha të ndryshme mes vendeve
D) asnjë nga këto

Pyetja 62.
Hapësira gjeografike përfshin në vetvehte gjithçka qe zhvillohet ne te. Elementet e saj:
A) janë të pandryshueshëm
B) ndryshojnë gjatë kohëve
C) ndryshojne në hapsirë dhe në kohë
D) asnjë nga këto

Pyetja 63.
Hapsira sociale përfaqson:
A) hapsirën gjeografike
B) materien e vendeve sociale
C) "arenën" e veprimtarisë sociale
D) asnjë nga këto

Pyetja 64.
Krahasimi i hapsirës sociogjeografike me një pikturë që nuk qendron statike por është në lëvizje të përhershme lidhet më:
A) Isard
B) Ruhl
C) Scholler
D) Jaxhke

Pyetja 65.
Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk ndikon në zhvillimin e hapsirës sociogjeografike:
A) faktorët formues
B) faktorët historike
C) faktorët gjeografike
D) faktorët sociale

Pyetja 66.
Elementi që konfiguron një strukturë sociale është:
A) periudha kohore
B) grupet sociale
C) ambjenti fizik
D) ambjenti etik

Pyetja 67.
Shtresat sociale janë një grupim i zgjeruar individësh që në bazë të nje tipari të caktuar:
A) arrijnë të fitojnë
B) arrijnë të mbijetojnë
C) arrijnë të individualizohen
D) arrijnë të arsimohen

Pyetja 68.
Tipari më dallues i klasave të ndryshme sociale është së:
A) janë në antagonizëm të papajtueshëm mes tyre
B) janë në marërdhënie mjaft të mira mes tyre
C) bashkohen nga i njejti qellim apo ide
D) asnjë nga këto

Pyetja 69.
Grupet sociale gjatë aktivitetit apo veprimtarisë së përditshme tentojnë aktivisht e janë në levizje që të mundësojnë edhe rregullimin cilësor apo përsosjen e vendeve të tyre sociale. Një gjë e tillë përfaqson:
A) zhvillim social
B) lëvizje sociale
C) konflikt social
D) qëllim social

Pyetja 70.
Në sa grupime themelore i ndajmë vendet sociale
A) 4
B) 5
C) 6
D) 7

Pyetja 71.
Cili nga emërtimet e mëposhtme nuk përbën vende sociale përfaqsuese
A) Vende sociale të banimit
B) Vende sociale të prodhimit
C) Vende sociale të ushqimit
D) Vende sociale të argëtimit

Pyetja 72.
Cili nga elementet e mëposhtëm nuk është pjesë e hapsirës rurale:
A) territor me dendësi të vogël popullsie e vendbanimesh
B) aktivitet bujqësor dominues
C) aktivitet industrial dominues
D) zhvillim të dobët të sferës së sherbimeve

Pyetja 73.
Sa funksione bashkëjetojnë në një hapsirë rurale?
A) 3
B) 4
C) 5
D) 6

Pyetja 74.
Cili nga elementet e mëposhtëm nuk realizohet nga *rregullimi rural*:
A) korigjimi i disekuilibreve të krijuara
B) frenimi i eksodit të popullsisë rurale
C) përcaktimi i përparësive soc-ekonomike
D) realizimi i barazisë me zonën urbane

Pyetja 75.
Në sa etapa realizohet rregullimi rural?
A) 2
B) 3
C) 4
D) 5

Pyetja 76.
Rregullimi rural është më tepër:
A) një politikë rajonale
B) një strategji afatgjatë zhvillimi
C) një politike kombetare
D) një politikë e zhvillimit bujqësor

Pyetja 77.
Drejtimet e zhvillimit rural kanë karakteristika të perbashkëta për vendet në zhvillim.
